



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e -II-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
14 mars 2018 në sallën e Kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Lutfi Bilalli dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Shpëtim Zhegrova dhe Melihate Basholli – Latifi.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Adnan Lahu, Berat Sadiku, Sedat Rashica, Sylejman Mehulli), Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar, Alban Tahiraj, zyrtar i lartë në zyrën ligjore, Shukrane Begu nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, nga sekretaria e kuvendit: Haki Maloku, Bastri Duraku, Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ai deklaroi se kanë ardhur disa propozime që të futen në rend të ditës:

- a) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim për Ministrinë e Punëve të Brendshme - Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
- b) Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e monografisë: “Pishtarët e arsimit shqip në Vushtrri e rrethinë 1915-2018”.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.02.2018;
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta;
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë-OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (**shqyrtimi i parë**);
5. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;

6. a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim për Ministrinë e Punëve të Brendshme-Akademisë së Kosovës për Siguri Publike,

b. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e monografisë: “Pishtarët e arsimit shqip në Vushtrri e rrethinë 1915-2018”.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 12.02.2018.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2017.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – lidhur me shpenzimet për karburante në vitin 2017 në shumën 62,706.69€, pyeti se këto shpenzime të karburanteve a janë vetëm për vetura, apo edhe për diçka tjetër. Gjithashtu ajo pyeti edhe lidhur me ndërtimin e parqeve, që është paraqitur në këtë raport. Ku janë planifikuar të ndërtohen këto parqe.

Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar – sqaroi se, shpenzimet për karburante përfshijnë të gjitha shpenzimet për vetura në: shëndetësi, arsim, zjarrfikësit dhe autoparku. Ndërkaq, lidhur me kodin ekonomik “ndërtimi i parqeve”, ai tha se ky kod ekonomik nënkupton rregullimin e të gjitha hapësirave publike.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se zjarrfikësit kanë shpenzime më të mëdha të karburanteve se sa komuna. Arsyeja sipas kësaj qëndron në atë se, pothuajse çdo natë dalin për t’i shuar zjarrin në kontejner, që dikush po i djeg mbeturinat. Përveç kësaj, edhe automjetet e vjetruara që zjarrfikësit i kanë në dispozicion, shpenzojnë karburante më shumë. Pastaj lidhur me ndërtimin e lapidarit të Batalionit të Parë, të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës, ai tha se ka mbi dhjetë vite që po mundohemi ta ndërtojmë këtë lapidar, mirëpo deri më tani nuk është arritur kjo gjë. Vitin e kaluar, u caktua lokacioni për ndërtimin e këtij lapidari në fshatin Gllavatin, ku edhe janë ndarë mjetet financiare, mirëpo qeveria e kaluar, nuk arriti që ta fillojë këtë projekt. Arsyetimi në këtë raport, ishte se: “procedura e prokurimit nuk ka pasur sukses për shkak të planifikimit jo të mjaftueshëm të mjeteve financiare”. Shpresoj se nuk do të ndodhë e njëjta gjë edhe me këtë qeverisje, theksoi ai.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se mirë do të ishte sikur të bëhej krahasimi i periudhës janar-shkurt 2018 me periudhën janar-shkurt 2017 për kuvend, që ta kemi një pasqyrë se qeveria e re a është në nivelin e duhur të shpenzimeve, pra a po shpenzon më pak apo më shumë.

Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar – sqaroi se, pas përfundimit të tremujorit, në muajin prill është e paraparë edhe me Plan të punës së kuvendit, “shqyrtimi i raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore”, ku bëhen krahasime me tremujorin e vitit paraprak.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha që edhe më herët, por edhe tash po na përcjell problematika e njëjtë, ku në këtë raport janë përdorur terma ekonomikë në tabela, kurse nuk është bërë elaborimi i tyre, sepse në disa raste është problem të kuptohen këta terma. Ai kërkoi nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që për kuvend të na sjell një shtojcë me sqarime të këtyre termave ekonomikë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha që pajtohet me këtë se ekzistojnë disa tabela që është vështirë të kuptohen. Mirëpo, ai tha se kjo shtojcë me sqarime të termave ekonomikë të kërkohet nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – kërkoi që kjo porosi t'i përcillet drejtorit, në mënyrë që në kuvend, këtij raporti t'i bashkëngjitet një shtojcë me zbërthimin dhe elaborimin e termave ekonomikë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë-OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (**shqyrtimi i parë**).

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se në këtë draft thuhet se: pagesa e qirasë së banimit nuk mund të bëhet më tepër se për pesë (5) vite. Ai pyeti se: pagesa e qirasë së banimit a mund të vazhdohet edhe pas afatit prej 5 viteve.

Albanez Tahiraj, anëtar i komisionit hartues – sqaroi se fillimisht ishte ideja që afati të jetë 4 vjeçar (qysh ka qenë në të kaluarën), për shkak të mandatit qeverisës që është i njëjtë (4 vjeçar) në mënyrë që të mos haset në ndonjë vështirësi. Mirëpo, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale e kemi lënë afatin 5 vjeçar. Ai shtoi se qiraja nuk i vazhdohet pas afatit pesëvjeçar të shfrytëzimit, kurse theksoi se kuvendi është ai që vendos.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se nëse qiramarrësi e zgjidh çështjen e banimit brenda afati 4 apo 5 vjeçar. Ai pyeti se: cili do të ishte mekanizmi që ta vërtetojmë se qiramarrësi e ka zgjidhur çështjen e banimit.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – deklaroi se çdo vit planifikohet buxheti për banim social. Sipas tij, komisioni vlerësues që formohet nga drejtoria e verifikon secilin rast. Nëse komisioni vlerëson se, dikush e ka zgjidhur çështjen e banimit, atëherë me vendim i ndërpritet kontrata. Ai tha se kontrata mund t'i ndërpritet edhe brenda 3 muajve. Mirëpo, nëse nuk i ka përmirësuar kushtet e

banimit, apo nuk ka bërë zgjidhje, atëherë brenda 1 viti nuk kemi të drejtë t'ia ndërpresim kontratën.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se pse komuna të hartojë rregullore, kur kryetari i komunës nuk i respekton rregulloret e qeverisë. Lidhur me këtë: “Personat juridikë janë vetëm organizatat joqeveritare të karakterit përfitues”, dhe a kishte me qenë ma mirë të gjendet ndonjë term tjetër.

Albanez Tahiraj, anëtar i komisionit hartues – tha që pajtohet me atë që “persona juridikë” është koncept më i gjerë, mirëpo në këtë draft-rregullore si persona juridikë trajtohen vetëm OJQ-të.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – theksoi se i përgëzon hartuesit për çështjen e bashkëfinancimit që është sqaruar në këtë draft-rregullore, ku thuhet se deri në 49% të vlerës, kryetari ka të drejtë që të vendosë për të lidhur marrëveshje për bashkëfinancim dhe kuvendi i komunës mbi 50% ka të drejtë që të vendosë për të lidhur marrëveshje për bashkëfinancim.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se pasi që u potencua nga Neziri çështja e mosrespektimit të rregullores nga kryetari. Desha ta di se cilën rregullore nuk po e zbatojmë si qeveri komunale.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se nuk fola si qeverisje komunale, mirëpo thash që kryetari i komunës nuk po e respekton Ligjin Nr. 03/L-32 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 19/2011 për kriteret e përzgjedhjes dhe vendosjes së fotografisë së Presidentit të Republikës së Kosovës. Këtë ia kam thanë kryetarit edhe në mbledhjen e kuvendit të komunës tha ai.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti lidhur me aplikimet për legalizim të objekteve pa leje, se a janë proceduar më tutje kërkesat apo çfarë ka ndodh.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se kjo çështje nuk është trajtuar për shkak të ndërprerjes së ligjit, por edhe për shkak se nuk ka qenë e specifikuar taksa. Janë aktualisht 80 kërkesa dhe jemi në pritje të ligjit të ri të legalizimit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim për Ministrinë e Punëve të Brendshme - Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – e përgëzoi drejtorin e Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për këtë propozim të kompletuar që siç tha ai është një dallim i madh

me propozimin e dërguar në mbledhjen e kuvendit të komunës. Me këtë propozim kërkohet që t’ia japim në shfrytëzim 40 ari Akademisë për Siguri Publike. Mirëpo, edhe para tri viteve e kam thënë, po e them edhe tash që të gjendet mundësia e këmbimit të pronave, e jo çdo herë komuna të japë pronat e saj në shfrytëzim pa kompensim. Hapësira në të cilën gjendet Shkolla e Policisë, mbi 5 hektarë janë pronë e komunës. Sipas tij, komuna jonë ka nevojë për një sipërfaqe, ndërsa, Ministria e Drejtësisë ka një sipërfaqe prej 2 hektarë e 12 ari tek ish-“Vicianumi”. Sa kam qenë drejtor në Drejtorinë për Kadastër, kam provuar që të gjejmë një mirëkuptim me Ministrinë e Drejtësisë që të bëjmë këmbim të pronave, mirëpo nuk kam arritur. Prandaj, qeverisja komunale të provojë mos po gjen mirëkuptim me Qeverinë e Kosovës për këmbim të pronave, tha Klinaku.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se pajtohet me atë që e tha Neziri, se aty ku ka mundësi të bëhet këmbimi i pronave, qysh e kemi rastin me gjykatën ku është bërë këmbimi i pronave. Lidhur me propozimin për dhënien në shfrytëzim të Akademisë për Siguri Publike, ai tha se kur është dhënë në shfrytëzim në vitin 2013, i është dhënë për shkak të interesit të përgjithshëm. Prandaj, konsideroj që është në interes të përgjithshëm që t’i jepet në shfrytëzim, pasi që aty parashihet që të ndërtohet Fakulteti për Siguri Publike.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se edhe unë pajtohem që t’i jepet në shfrytëzim. Mirëpo, mirë do të ishte të caktohet një takim me ministrin apo me dikë nga qeveria e Kosovës dhe të provohet mundësia për këmbim.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se edhe unë pajtohem që t’i jepet në shfrytëzim, por fillimisht të provohet mundësia e këmbimit.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – tha se ideja e Nezirit është shumë e mirë. Po e shoh praktikën në QKMF që na është dhuruar nga Ministria e Shëndetësisë, ku nuk ka hapësirë as për parking, as nuk ka hapësirë për shërbimin laboratorik, e as shërbimin e rëntgenit.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se kryetari i komunës këto ditë e ka caktuar një takim me ministrin e drejtësisë për të biseduar lidhur me pronat komunale.

Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi njëzëri që të provohet me qeverinë e Kosovës që aty ku ka mundësi të bëhet këmbimi i pronave dhe kompensimi.

b. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e monografisë: “Pishtarët e arsimit shqip në Vushtrri e rrethinë 1915-2018”.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – lidhur me këtë, ai deklaroi se autori i këtij libri ishte dje në zyrë tek unë dhe më njoftoi me përmbajtjen e librit. Por, ai kërkoi përkrahje financiare për ta botuar këtë libër. Po ashtu, ai kishte qenë edhe tek kryetari më herët për këtë çështje, por kryetari kërkesën e tij e ka përcjellë tek Drejtoria për Arsim. Pastaj tha se mua m’u duk një përmbledhje interesante e kësaj monografie, e cila do t’ia servonte një të mirë fillimisht Drejtorisë për Arsim, e pastaj edhe arsimit në përgjithësi të komunës sonë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se, autori i këtij libri, Ferit Dibrani është ndihmuar çdo herë nga komuna. Pothuajse, nuk ekziston dikush tjetër që të ndihmohet përveç tij. Nuk jam kundër që ai ka shkruar monografi, por të shikohet se nëse ka marrë mjete financiare vitin e kaluar, nuk ka nevojë të përkrahet përsëri sivjet.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – kur e shoh këtë kërkesë, me gjithë këto gabime drejtshkrimore, e që është me titull profesor dhe këta njerëz të botojnë libra është për keqardhje. Ai kërkoi që të silllet drafti i librit në kuvend dhe të formohet një komision për vlerësimin e këtij libri dhe të shikohet se a i plotëson kriteret.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha që ne jemi ata që vendosim për t'i përkrahur. Ai ka bërë një kërkesë, nëse i përmbahet standardit tonë, ne e mbështesim. Bashkërisht duhet të krijojmë një standard dhe t'i caktojmë kriteret. Nëse ne nuk e ndërtojmë një standard dhe mbështesim gjithçka, atëherë të gjithë do të vijnë dhe do të kërkojnë fonde.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – theksoi se ai ka të drejtë të kërkojë, kurse kuvendi është ai që vendos dhe e vlerëson se a të përkrahet apo jo.

Haki Maloku, udhëheqës i sekretarisë – tha që, si komunë e kemi krijuar një përvojë lidhur me përkrahjen për botimin e librave. Ai tha se në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë ndarë subvencione për botimin e librave, dhe po ashtu në kuadër të drejtorisë është themeluar një komision vlerësues, që ta vlerësojë se cilat botime meritojnë që të përkrahen. Deri tani ka shkruar në këtë mënyrë, prandaj është mirë të shkohet në këtë mënyrë që komisioni ta vlerësojë çështjen e botimit. Në fund tha se është mirë t'i adresohet kërkesa drejtorisë dhe ajo ta vlerësojë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se mund të kemi përvoja të mira dhe të këqija nga e kaluara, për autorin në fjalë. Prandaj, konsideroj që gjykimi duhet të bëhet për librin, e jo për autorin. Ai theksoi se vlerësimi duhet të bëhet nga një komision profesional dhe gjithpërfshirës, ku duhet të jenë të përfshira Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – deklaroi se e njeh personalisht autorin, i cili me botimin e disa librave të botuara ka bërë një punë të mirë. Ai ka përshkruar gjendjen në arsim, sidomos në vitet që nuk kanë qenë të zbardhura rastet. Prandaj, edhe unë pajtohem që të formohet një komision nga Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në mënyrë që të bëhet vlerësimi që ta dimë se kënd po e subvencionojmë. Pastaj tha se në muajin e kaluar më ka ra në dorë një kërkesë, ku një aktor i njohur shqiptar ka kërkuar nga Komuna e Vushtrrisë që ta subvencionojë një film të një heroji kombëtar. Aktori më tha se kërkesa i është refuzuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me kryetarin e komunës, prandaj, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë të gjitha kërkesat dhe mos të ketë diskriminim ndaj asnjë kërkesë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – lidhur me refuzimin e kërkesës për artistin shqiptar, ai deklaroi se arsyeja e refuzimit ka qenë për shkak se ende nuk është miratuar

rregullorja për subvencione, kështu që jemi pajtuar që tani për tani nuk ka mundësi të subvencionohet, derisa të miratohet rregullorja.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri rekomandoi që Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ta shqyrtojnë këtë kërkesë, si dhe të formohet një komision për vlerësimin e kësaj monografie.

1. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **11:20**

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



Nasuf Aliu
Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së